

VENDIM
Nr. 332, datë 9.7.2024

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR BASHKIMIN E PROCEDIMEVE
DISIPLINORE, NË RASTET KUR NJË GJYQATAR DHE NJË PROKUROR,
JANË TË PËRFSHIRË NË TË NJËJTËN SHKELJE DISIPLINORE”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 140, nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenin 140, pika 2, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenet 97, 98 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, mbi propozimin e Komisionit Disiplinor,

VENDOSI

1. Miratimin e rregullore “Për bashkimin e procedimeve disiplinore, në rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror, janë të përfshirë në të njëjtën shkelje disiplinore”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
ZËVENDËSKRYETAR
Ilir Rusi

RREGULLORE

**PËR BASHKIMIN E PROCEDIMEVE DISIPLINORE, NË RASTET KUR NJË
GJYQATAR DHE NJË PROKUROR, JANË TË PËRFSHIRË NË TË NJËJTËN SHKELJE
DISIPLINORE**

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i rregullore

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është hartimi i rregullave për procedim të përbashkët, kur një gjyqtar dhe një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje.

2. Në zbatim të kësaj Rregulloreje do të konsiderohet se një gjyqtar dhe një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje disiplinore kur, të dy, bazuar në të njëjtat fakte, kryejnë të njëjtën shkelje ose një shkelje që, për nga natyra e saj, mund të konsiderohet ekuivalente duke pasur parasysh pozicionin dhe kompetencat e ndryshme profesionale të atyre që janë të përfshirë.

Neni 2

Parimet e përgjithshme

1. Pasi të jetë miratuar bashkimi i procedimeve, asnjë bashkim tjetër i mëtejshëm procedimesh, bazuar në fakte të tjera, në përputhje me dispozitat e nenit 140(1) të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkeljet e pretenduara të kryera veçmas, nuk do të jetë më i mundur.

2. Për çdo çështje që nuk është rregulluar në mënyrë specifike nga kjo Rregullore, do të zbatohen rregullat procedurale të përgjithshme, të parashikuara në ligjin nr. 96/2016.

Neni 3

Fillimi i procedurës disiplinore

1. Pasi të ketë përfunduar hetimi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon procedimin disiplinor, duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.
2. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë konsideron se hetimet duhet të mbyllën vetëm për njërin nga dy personat nën hetim, ai e argumenton vendimmarrjen e tij në raportin e hetimit.

Neni 4

Përpunimi i dosjeve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë

1. Secili Këshill është plotësisht i pavarur në trajtimin dhe vendimmarrjen e çështjes disiplinore që lidhet me magistratët, të cilët janë në fushën e tij të kompetencës.
2. Këshillat përkatëse duhet të marrin vendimin për bashkimin e procedimeve brenda një periudhe dhjetëditore nga marrja e raportit të hetimit.
3. Nëse njëri nga dy Këshillat nuk e merr këtë vendim, bashkimi i procedimeve nuk do të ndodhë dhe, që nga ai moment e në vazhdim, procedurat do të vijojnë veçmas.
4. Këshillat, pa vonesë, njoftojnë njëri-tjetrin për vendimet përkatëse. Po ashtu, vendimi do t'i njoftohet palëve në proces.
5. Pas regjistrimit dhe vendimit për bashkim, çështja do të hidhet menjëherë në short për caktimin e relatorit.

Neni 5

Rastet e ndarjes pa vendim të veçantë

Procedimet do të vijojnë të ndara, edhe nëse paraprakisht është marrë vendim për bashkimin e tyre, në rastet e mëposhtme:

- a) nëse njëri nga dy Këshillat kërkon nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë të kryejë hetime të mëtejshme, në përputhje me dispozitat e nenit 138(5) të ligjit nr. 96/2016.
- b) nëse njëri nga dy Këshillat pranon të mbyllë procedimet pa një seancë dëgjimore, pasi vlerëson se ka ndodhur ndonjë nga rastet e parashikuara në nenin 139 të ligjit sipërpërmendur.
- c) nëse ndryshon ose zgjerohet fushëveprimi i procedurës disiplinore në përputhje me nenin 144 të ligjit në fjalë.
- d) Nëse njëri nga Këshillat pezullon procedimet bazuar në dispozitat e nenit 145 të ligjit të lartpërmendur.

Neni 6

Procedura

Për të garantuar standard të njëjtë përgjatë procedurës disiplinore, çdo rast do të trajtohet sipas rregullave të përgjithshme, duke marrë parasysh sa më poshtë:

- a) Pasi të jenë caktuar relatorët përkatës nga çdo Këshill, ata do të mbajnë një takim fillestar, në vendin e rënë dakord, në mënyrë që të informojnë njëri-tjetrin për qasjet përkatëse, veçanërisht mbi arsyet e bashkimit të procedimeve.

Ata, gjithashtu, mund të informojnë njëri-tjetrin për mundësitë që Këshillat respektivë të vendosin mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore ose, në të kundërt, të caktojnë datën në të cilën do të zhvillohen seancat dëgjimore.

Marrëdhëniet dhe komunikimet mes relatorëve zhvillohen përmes kanaleve zyrtare.

- b) Nëse njëri nga Këshillat urdhëron mbylljen e procedimit disiplinor, ai do të informojë menjëherë Këshillin tjetër, nëpërmjet relatorit përkatës.

c) Relatorët do të ndërmarrin takime sipas nevojës, duke vepruar në besnikëri të plotë, duke mundësuar qëndrime të përbashkëta, veçanërisht për përcaktimin e fakteve të vërtetuara.

d) Gjithashtu, relatorët duhet të informojnë njëri-tjetrin për statusin e çdo veprimi procedural që kryhet, duke kërkuar, për aq sa është e mundur dhe në respektim të plotë të fushës së tyre të veprimit, koherencën më të madhe në vendimin përfundimtar.

e) Relatorët do të mundësojnë, sa herë që është e mundur, që Këshillat përkatës të japin përgjigje të njëjtë ndaj kërkesave të palëve për prova, shtyrjen e seancës dëgjimore, kërkesën për pezullimin e procedurës, për shkak të ekzistencës së një hetimi penal apo procesi gjyqësor që ka rëndësi për procedimin disiplinor, si dhe çdo kërkesë apo çështjeje tjetër që mund të ngrihet.

f) Relatorët duhet të përpiqen të sigurojnë që seancat dëgjimore disiplinore të mbahen në të njëjtën ditë. Nëse kjo nuk është e mundur, përpiqen të mbahen sa më afër njëra-tjetrës të jetë e mundur. Nëse ato janë planifikuar në të njëjtën ditë, duhet të evitohet që mbajtja e njëres seancë të mund të paragjykojë mbajtjen e tjetrës, nëse të njëjtët persona duhet të marrin pjesë në të dyja seancat.

g) Në hartimin e vendimit përfundimtar, çdo relator do të kërkojë konsistencën maksimale në përcaktimin e fakteve të vërtetuara, pa paragjykuar vlerësimin ligjor të këtyre fakteve nga secili Këshill.

Gjithashtu, ata do të përpiqen të sigurojnë që, nëse është e mundur dhe pa cenuar të drejtat e palëve, njoftimi i vendimit disiplinor të bëhet në të njëjtën datë.

KREU II DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 7 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.